

Albanian Energy Supplier Sh.p.k
Shenimet shpjeguese për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

(Të gjitha shumat janë shprehur në Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Albanian Energy Supplier Sh.p.k (këtu më poshtë “Shoqëria” ose “AES”) është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 04 nëntor 2014 pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L42304017T.

Objekti i Shoqërisë është import, eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike.

Aksioner i vetëm i Shoqërisë është Shoqëria Balfin sh.p.k. e cila zotëron 100% të aksioneve. Që nga 18 Nentor 2020 Shoqëria administrohet nga Znj. Megi Hadushi.

Adresa kryesore e Shoqërisë është: Rruga “Brigada VIII”, Pallati Nr.19, Kati 3, Zyra 4

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria ka 16 punonjës dhe në (2019: 14).

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

a. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet, amendimet dhe interpretimet në vijim, hyjnë në fuqi për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2020 ose pas kësaj date:

- Perditesime te Referencimeve ne Kuadrin Konceptual te standardeve SNRF 1 Janar 2020;
- Perkufizimi i nje Biznesi (Perditesime te SNRF 3) 1 Janar 2020;
- Perkufizimi i te qenit Material (Perditesime ne SNK 1 dhe SNK 8) 1 Janar 2020;
- Reforma e Normës së Interesit Referuese (Perditesime në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7) 1 Janar 2020.
- Koncesionet e Qirave që lidhen me COVID-19 (Ndryshim në SNRF 16) 1 Qershor 2020

Pervec sa me sipër nuk ka patur standarde apo interpretime të tjera te reja, të cilat kanë hyrë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2020 ose pas kësaj date, që të kenë efekt të qenësishëm në pasqyrat financiare të kompanisë.

b. Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të papërvetësuar

Nje numer standardesh, amendimesh dhe interpretimesh hyjnë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2021 ose pas kësaj date, e megjithate Shoqëria nuk i ka aplikuar keto standarde te reja ose te rishikuara ne pergatitjen e ketyre pasqyrave financiare si me poshte vijon:

Efektive qe prej 1 Janarit 2021:

- Kontratat e Sigurimit SNRF 17;
- Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurtër ose afatgjatë (Perditesime në SNK 1) ende e papërvetësuar;
Shitja ose kontributi ne aktive ndermjet Investitorit dhe Bijes ose Shoqerise se Perbashket (Perditesime ne SNRF 10 dhe SNK 28).

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël

3.1 Baza e përgatitjes dhe përputhshmërisë

a) Baza e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”) dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“KINRF”) të BSNK. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuar nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e vlerësimit janë përshkruar në mënyrë më të qartë në politikat kontabël të paraqitura si më poshtë.

b) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në “Lek” e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

c) Përdorimi i gjykimit dhe i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në ato pasardhëse të ndikuara nga ky ndryshim. Në veçanti, informacioni mbi fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve të rëndësishme në aplikimin e politikave kontabël, që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar më poshtë.

Tatim fitimi

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Gjykim i rëndësishëm kërkohet në përcaktimin e shumës së tatim fitimit aktual dhe tatimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi i tatimit është i pasigurt. Shoqëria njihet detyrime për çështje të pritshme të kontrollit tatimor bazuar në vlerësimet se tatime shtesë do mund të lindin si detyrime. Kur rezultati përfundimtar i tatimit për këto çështje është ndryshe nga shumat e regjistruara fillimisht, diferencat do të ndikojnë në aktivin dhe detyrimin tatimor aktual dhe të shtyrë në periudhën kur bëhet përcaktimi.

Të ardhurat nga kontratat me klientët

Shoqëria aplikoi gjykimet e mëposhtme të cilat ndikojnë në mënyrë të rëndësishme në përcaktimin e shumës dhe kohës për njohjen e të ardhurave nga kontratat me klientët:

i. Identifikimi i detyrimeve të performancës nga tregtimi i energjisë

Shoqëria është e përfshirë në tregtimin dhe furnizimin e energjisë elektrike në tregun e brendshëm. Ajo ka lidhur kontrata shitje dhe furnizimi me klientët, në të cilat premtim shiten e energjisë sipas kontratave individuale. Shoqëria ka detyrimin të furnizojë blerësit për sasi të dakortësuara në pikat e lëvrimit mes palëve. Për shitjen e energjisë, transferimi zakonisht ndodh kur sasia aktuale e energjisë injektohet në rrjet dhe matet në pikën e matjes çdo fund-muaji.

ii. Mallra apo shërbime të dallueshme

Kontratat për furnizimin me energji përbëjnë një detyrim të veçantë të performancës të cilat janë lehtësisht të dallueshme dhe veçmas të identifikueshme. Prandaj Shoqëria cakton çmimin e transaksionit bazuar në çmimin e pavarur të shitjes së shërbimeve.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

3.1 Baza e përgatitjes dhe përputhshmërisë (vazhdim)

c) Përdorimi i gjykimit dhe i vlerësimeve (vazhdim)

Shërbimi dhe tregtimi i energjisë është një tip dhe i vetëm ndaj mund të identifikohet në mënyrë individuale me një çmim individual. Çmimi i shitjes mund të identifikohet lehtësisht në kontratat e shitjes. Rrjedhimisht Shoqëria ka alokuar çmimin e transaksionit për secilin rast të shpërndarjes së energjisë në baza individuale duke u bazuar në kontratat me klientë.

iii. Natyra dhe koha e përmbushjes së kushteve të performancës

Shoqëria ka arritur në konkluzionin që detyrimi i performancës për furnizimin me energji elektrike njihet në momentin e transmetimit të energjisë sipas dorëzimit të skeduleve dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Për të arritur në këtë konkluzion Shoqëria ka vlerësuar nëse:

- Klienti ka rënë dakort me përmbushjen e detyrimit për sasitë e dakortësuara
- Furnizimi i energjisë është bërë në përputhje me termat e kontratës (pika e lëvritimit, periudha e lëvritimit, furnizimi sipas skeduleve të dakortësuara)
- Njësisë ekonomike i ka lindur e drejta aktuale për tu paguar për shitjen e energjisë

Shoqëria njih të ardhurat në baza mujore për energjinë e lëvruar në fund të muajit për çdo klient.

iv. Përcaktimi i shumave të ndryshueshme

Shoqëria mund të ketë të drejtën e vendosjes së penalteteve për pagesat me vonesë sipas kontratave të saj me klientët, e cila është vlerësuar duke përdorur metodën 'shuma më e mundshme'. Meqë kjo shumë e ndryshueshme nuk konsiderohet e mundshme të ndodhë bazuar në historikun e transaksioneve si dhe në termat e pagesave (brenda 30 ditëve nga data e faturimit), Shoqëria nuk i ka përfshirë këto shuma në çmimin e transaksionit të saj.

3.2 Parimi i vijimësisë

Bazuar në pozicionin e likuiditetit të Shoqërisë në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, si dhe në pasigurinë që rrethonë vazhdimësinë e ardhshme të shpërthimit pandemik, drejtimi vlerëson se nuk ka nevojë për financim shtesë për të përmbushur detyrimet e saj financiare.

Ekziston ende një pasiguri e rëndësishme se si pandemia do të ndikojë në biznesin e Shoqërisë në periudhat e ardhshme.

Kufizimet dhe rregulloret e COVID-19 kanë ndryshuar gjatë gjithë periudhës bazuar në përhapjen e virusit në Shqipëri. Që nga data e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, është e vështirë të vlerësosh kufizimet e mundshme që do të zbatohen në Shqipëri, dhe si rezultat, është e vështirë të përgatitësh një gamë të mundshme skenarësh për çdo ndikim të mundshëm në operacionet e Shoqërisë për periudhat e ardhshme.

Megjithëse, ka ende paqartësi se si zhvillimi i ardhshëm i shpërthimit pandemic do të ndikojë Shoqërinë, drejtimi ka një besim të arsyeshëm se ajo ka burime të përshtatshme për ti përballuar.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë dhe nuk përfshijnë ndonjë rregullim të vlerës kontabël dhe klasifikimit të aktiveve, pasiveve dhe shpenzimeve të raportuara që përndryshe mund të kërkohen nëse baza e parimit të vijimësisë nuk do të ishte e përshtatshme.

3.3 Transaksionet në monedha të huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

3.3 Transaksionet në monedha të huaja (vazhdim)

Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Monedha	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/LEK	123.7	121.77
USD/LEK	100.84	108.64

3.4 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjeteve monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

3.4 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas.

Aktivet financiare – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësitë ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësitë ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivitetit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategorite e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhet (dmth. kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Shoqëria zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

3.4 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbëhet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikën e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Të arkëtueshmet nga palët e lidhura me 31 dhjetor 2020 përbëjnë 71% të balancës së llogarive të arkëtueshme (31 dhjetor 2019: 88%). Shoqëria është 100% e sigurt që do arkëtojë llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura, pasi ka njohuri dhe besim të plotë në aftësinë paguese të kompanisë palë të lidhur, por mbi të gjitha të vetë grupit.

Huamarrjet

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3.5 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë gjëndjet e arkës, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat afatshkurtra bankare. Për qëllime të pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfaqësojnë para dhe depozita të pakufizuara me maturitet tre muaj ose më pak, të përcaktuara si më sipër e netuar me llogaritë e zbuluara bankare.

3.6 Provigjonet

Provigjoni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Provigjonet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

3.7 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe pensionet

Shoqëria, në rrjedhën normale të aktivitetit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e paguara nga Shoqëria regjistrohen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse të të ardhurave (fitim ose humbje) kur ndodhin.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

Leje vjetore e paguar

Të gjithë punonjësit kanë të drejtën e lejes vjetore të paguar bazuar në legjislacionin aktual vendas. Politikat e kompanisë nuk parashikojnë rimbursimin e lejeve të pa shfrytëzuara. Ato duhet të zbatohen sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

3.8 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i Shoqërisë njihet në vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

3.9 Aktivet afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuar (nëse ka). Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese, të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

▪ Paisje Informatike	4 vjet
▪ Paisje dhe mobilje zyre	5 vjet
▪ Instalime teknike	5 vjet
▪ Godina Nënstacioni	25 vjet
▪ Makineri dhe Pajisje Elektrike	30 vjet
▪ Linja Elektrike	30 vjet

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

3.10 Zhvlerësim i aktiveve jo financiare

Në çdo datë raportimi Shoqëria rishikon vlerën kontabël të aktiveve jo-financiare, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra për të përcaktuar nëse ka tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit në mënyrë që të përcaktohet zhvlerësimi. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes.

Për përcaktimin e vlerës në përdorim, skontothen flukset e ardhshme të parasë duke përdorur normën e skontimit para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike të aktivitetit, për të cilat nuk janë bërë rregullime në vlerësimet e bëra për fluksin e mjeteve monetare.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse.

3.11 Të ardhurat nga kontratat me klientët

Furnizimi me energji

Shoqëria ka aktivitet kryesor tregtimin dhe furnizimin me energji elektrike si dhe shërbime të tjera të lidhura me to. Të ardhurat nga furnizimi me energji njihen në fund të muajit pas rakordimit mes palëve që bashkëveprojnë në transaksionet e shit/blerjes së energjisë, kostot e lidhura dhe kthimet e mundshme mund të maten me besueshmëri dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. E ardhura njihet me vlerën e drejte të shumës së marrë ose për tu marrë, neto nga kthimet.

Shoqëria konsideron se ka edhe premtime të tjera në kontratë që janë detyrime të performancës të cilat janë të detyrueshme për tu përmbushur.

Në përcaktimin e çmimit të transaksionit për tregtimin e energjisë Shoqëria merr parasysh efektet e konsideratës së ndryshueshme, ekzistenca e komponentëve të rëndësishëm të financimit dhe konsideratës jo monetare.

i. Konsiderata të ndryshueshme

Zbritjet tregtare trajtohen si konsideratë e ndryshueshme dhe përfshihen në të ardhura kur ekziston probabilitet i lartë që nuk do të ketë ndryshim të konsiderueshëm të shumës së akumuluar të të ardhurave kur pasiguri të ndryshme të çmimit të qartësohen.

Në kontratat që i lejojnë klientit kthimin e shërbimit, të ardhurat do të njihen kur ekziston probabilitet i lartë që nuk do të ndodhë kthim i konsiderueshëm në të ardhurat e akumuluar të njohura. Rrjedhimisht të ardhurat e njohura do të rregullohen për kthimet e pritura, të cilat vlerësohen duke u bazuar në të dhëna historike. Në këto rrethana njihet një detyrim për rimbursim dhe një e drejtë për të rimarrë mallin e kthyer. Shoqëria në bazë të historikut nuk gjykon rrezikun e kthimeve në të ardhmen.

ii. Komponent i rëndësishëm i financimit

Përgjithësisht Shoqëria nuk operon nëpërmjet parapagimeve me klientët. Dhe në rastet kur operohet nëpërmjet këtyre parapagimeve ato janë për periudha më të shkurtra se 30 ditë, si rrjedhojë kompania nuk bën axhustime në llogaritë përkatëse.

3. Përmbledhje e politikave bazë kontabël (vazhdim)

3.11 Të ardhurat nga kontratat me klientët (vazhdim)

Aktivi i kontratës

Një aktiv i kontratës është e drejta e njësisë ekonomike për një shumë korresponduese në këmbim të furnizimit me energji elektrike tek klienti. Nëse Shoqëria furnizon me energji elektrike një klient para se sa klienti të paguajë shumën korresponduese ose përpara maturimit të pagesës, aktivi i kontratës njihet për shumën korresponduese e cila është e kushtëzuar. Shoqëria njih si Aktiv të kontratës llogaritë e arkëtueshme nga klientë.

Detyrimet e kontratës

Detyrimet e kontratës janë detyrimet e njësisë ekonomike për të furnizuar me energji elektrike klientin për të cilin njësia ekonomike ka marrë shumën korresponduese (ose ka të drejtë për një shumë korresponduese) nga klienti. Nëqoftëse klienti paguan shumën korresponduese përpara se njësia ekonomike të furnizojë me energji klientin, një detyrim kontrate njihet kur pagesa është bërë ose është maturuar. Detyrimet e kontratës njihen si të ardhura kur kompania përmbush kushtet e performancës së kontratës.

3.12 Qiratë

Shoqëria vlerëson në fillim të çdo kontrate nëse është apo përmban një qira. Kjo ndodh në rastet kur një kontratë përcjell të drejtën për të kontrolluar një aktiv të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Shoqëria përdor një qasje të vetme në njohjen dhe matjen e të gjitha qirave, me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe atyre për të cilat aktivi bazë është me vlerë të ulët.

i) Aktiv me të drejtë përdorimi

Shoqëria njih një aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë (p.sh. data kur aktivi është i gatshëm për përdorim). Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi dhe ndonjë korigjim për rimatjet e detyrimit të qirasë. Kosto e aktivit me të drejtë përdorimi përfshin detyrimin e qirasë së njohur, kostot direkte dhe pagesat e qirasë të bëra në/përpara datës së fillimit, minus ndonjë stimul qeraje të marrë. Aktivi me të drejtë përdorimi amortizohet me metodën lineare për periudhën më të shkurtër midis kohëzgjatjes së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

ii) Detyrimi i qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njih një detyrim të qirasë së matur me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të cilat nuk janë paguar ende në atë datë. Pagesat, përfshijnë pagesat fikse minus ndonjë stimul qiraje të marrë, pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen nga ndonjë indeks apo normë e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit, dhe vlerat e pritshme për tu paguar nga qiramarrësi sipas vlerës së mbetur të garancive. Gjithashtu pagesat e qirasë përfshijnë çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje nëse qiramarrësi ka siguri të arsyeshme për të ushtruar atë opsion. Pagesat e qirasë duhet të skontoohen duke përdorur normën e interesit të përcaktuar të qirasë, nëse kjo normë mund të përcaktohet lehtë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, qiramarrësi duhet të përdorë normën rritëse të huamarrjes së qiramarrësit. Detyrimet e qirasë përfshihen si huamarrje me interes.

iii) Qiratë afatshkurtra dhe qiratë me vlerë të ulët

